

MERITA BALLIÇI

KUPTIMI PËRGJITHËSUES NË GJUHËN SHQIPE

Vëzhgimi e qëmtimi i gjuhës në vepra të stileve dhe autorëve të ndryshëm¹ ka zgjuar interesin tonë për kuptimin përgjithësues në gjuhën shqipe. Kjo dukuri e cila takohet në struktura të caktuara gjuhësore, lidhet ngushtë me foljen, por jo vetëm, dhe vjen si e tillë në kuadrin e thënies. Kuptimi përgjithësues përftohet përmes një veprimi me vlerë përgjithësuese, një veprimi që i referohet apo përfshin çdo qenie njerëzore, gjithsecilin prej nesh. Përmes tij pohohen ose mohohen të gjithë, madje dhe vetë folësi.

Duhet thënë që kuptimi përgjithësues nuk është një çështje shumë e rrahur në gjuhësinë shqiptare dhe si i tillë, deri më sot, shihet vetëm në kuadrin e fjalive njëkryegjymtyrëshe me vetë të përgjithësuar². Ne do të përpiqemi ta kapërcejmë trajtimin e derisotëm duke synuar një vështrim më të gjerë të tij.

1. Vetorët ambigë (dyvlerësh)³

Shpjegimi i vetës si “kategori gramatikore e foljes, që tregon se kush flet, kujt i drejtohet folësi ose për kë a për se bëhet fjalë dhe që shprehet gjatë zgjedhimit me anën e trajtave të foljes e me anë të përemrave vetorë”⁴ e drejton vëmendjen tonë drejt foljes⁵, më saktë, drejt kuptimit gramatikor të

¹ Kemi vjelë shterueshëm vepra të J. Xoxës, I. Kadaresë, Dh. Shuteriqit, M. Kutelit, S. Frashërit, D. Agollit, F. Nolit e autorit Popull. Ky korpus përmbledh rreth 3400 faqe, përpos 224 faqe gazetash nga shtypi ynë i përditshëm.

² Fillimisht e takojmë kuptimin përgjithësues te Mehmet Çeliku, cikli i leksioneve “Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe”, Elbasan, 1980: “Fjali me vetë të përgjithësuar quhen ato fjali njëkryegjymtyrëshe që shprehin veprime që u përkasin të gjithë njerëzve e që foljen e kanë zakonisht në vetën e dytë numër njëjës. Në këto fjali folësi nuk i drejtohet një personi të caktuar, veprimi i shprehur nga folja e vetës II kryhet nga një vetë e përgjithësuar, ku mund të përfshihet edhe vetë folësi.” I njëjti qëndrim mbahet dhe në Gramatikën e Akademisë (sintaksa). Evidentohet sërish veta e dytë numër njëjës si veta më e zakonshme e përgjithësuar dhe te “Gramatika e Gjuhës Shqipe I (Morfologjia)”, Tiranë 1995, te “Gramatika praktike e gjuhës shqipe”, M. Çeliku, M. Karapinjalli, R. Stringa, 1998, te “Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)”, M. Çeliku, Tiranë 2012, si dhe nga Remzi Përnaska në një cikël leksionesh titulluar “Gjuhësia e të thënies”, mbajtur në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, mars 2012, ndërkohë që, për sa më lart, nuk përmendet vlera përgjithësuese në asnjërin prej fjalorëve të gjuhës shqipe.

³ Kemi zgjedhur këtë emërtim për vetorët që përdoren me kuptim të dyfishtë: të përcaktuar dhe të përgjithësuar (në rastin tonë).

⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, botim i dytë i ripunuar, Toena, Tiranë 2002, f. 1444.

⁵ Në artikullin e Shaban Demirajt, *Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe*, në SF, 1969/4, gjejmë dhe përdorimin e emrit të përgjithshëm me kuptim të përgjithësuar (kategorial). E kemi ndeshur kuptimin përgjithësues të emrave dhe në

foljes. Nocioni i vetës, ashtu si na vjen ai nga gramatika apo fjalorë shpjegues, është nocion abstrakt dhe gjatë zgjedhimit të foljes ne abstraktojmë me vetat, por në procesin e ligjërimit veta merr një shenjues konkret, sendëzohet, duke u kthyer nga vetë e abstraktuar në vetë të shenjuar dhe, kur bëhet fjalë për të vërteta të padiskutueshme apo thënie që i takojnë një grupi më të gjerë se thënës – bashkëthënës konkretë, atëherë veta merr një tjetër shenjues, një shenjues përgjithësues⁶. Në këtë rast, kur shenjojmë **Ti** nuk kemi parasysht vetëm bashkëthënësin, por çdo qenie që i takon racës njerëzore.⁷

1.1 Është e njohur që në gjuhën shqipe, në një kontekst të caktuar, ashtu si dhe e kemi hasur rëndom në korpusin tonë tashmë, **veta e dytë numër njëjës** mund të takohet si vetë e përgjithësuar, por ndryshe sa është thënë deri tani (vetëm në mënyrën dëftore, urdhërore e lidhore, koha e tashme), në kohët më të përdorshme dhe në të gjitha mënyrat e foljes⁸:

a) dëftore: e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë, e kryer, e ardhme, e ardhme e së shkuarës: *Pasqyra është një gjol i vogël që s'ka asnjë thellësi. Atje s'fut dot krahun dhe nuk kap dot asgjë.* (Lulja, vëll. 1, f. 317).; *Me t'u futur në këtë vendbanim të madh, hetoje e përjetoje ankthin e rrezikut, ...* (Lulja, vëll. 1, f. 175); - *Jo, kush shkon, nuk vjen prapë! Është si zogu i kuvlisë: posa ia hape, iku...* (Kuteli, f. 77); *Balozi mbante satërin ndër dhëmbë, vriste, priste, gllabëronte. Thuaj baloz e i ke thënë të gjitha mynxyrat...* (Kuteli, f. 159); *Nëqoftëse ke blerë një makinë jashtë kufijve, e ke importuar atë në Shqipëri dhe ende nuk e ke prerë doganën, do të lehtësohesh nga kjo barrë pagese.* (“Mapo”, 19 korrik 2011); *Po të afroheshe, do të shikoje se dërrasat e moçme të gjoksit, të ijeve e të shpinës ishin plasaritur nga dielli dhe shiu dhe ngjanin si lëkura e një përbindëshi, ndërsa këmbët e tij të rënda, me kalimin e viteve, qenë fundosur në tokë gjer në gju.* (Përbindëshi, f. 17)

b) lidhore: e tashme, e pakryer, e kryer: *Një diçka tjetër po dëgjohej ndërkaq. Të thoshe se ishte diçka që nuk pritej, ishte pak.* (Darka, f. 28); **Të**

Gramatikën Praktike. Në këtë të fundit sillen dhe shembujt e poshtëshënuar që tregojnë përdorimin e disa emrave të pashquar apo të shquar me kuptim të përgjithësuar si: *Një mësues i kulturuar nxjerr nxënës të kulturuar.; Qeni (çdo qen) është kafshë shtëpiake.* Por, rastet e mësipërme do të anashkalohen pasi nuk janë në interesin tonë. Qëllimi i këtij punimi nuk është marrja në shqyrtim e kësaj kategorie emrash, pasi ato kanë kuptim përgjithësues lidhur me një klasë të caktuar.

⁶ Po lemë pa përmendur shenjuesin e papërcaktuar pasi nuk është pjesë e këtij studimi.

⁷ Këtë ambiguitet, nën termin “*les transferts de personnes*”, e kemi vënë re dhe te gramatika franceze. Charaudeau, Patrick, “Grammaire du sens et de l’expression”, Paris, 1992, f. 140-162 (**Remarque:** l’interlocuteur-récepteur est multiple de par la situation de communication. Mais il est appelé à devenir unique à travers le **je**. un unique qui vaut pour **tous**... (slogan pour une campagne civique: “*Demain, je vote*” = votez.)).

⁸ Nëse do t’i referoheshim veprës “Gramatika praktike e gjuhës shqipe”, M. Çeliku, M. Karapinjalli, R. Stringa, 1998, që i njeh foljes 5 mënyra (f. 129-130).

jesh në Myzeqe, pa të shikosh. (Lulja, vëll. 2, f. 195); *Po ai drej gjol nuk ishte si toka, ku mund të përvihesh nëpër hendeqe e prapa gardhiqeve.* (Lulja, vëll. 1, f. 318).; *Nuk kam kërkuar falje, por mësova se ndonjëherë kur e tejkalon kufirin pak, në një situatë vërtet serioze, me dikë që mund të mos ketë sens të njëjtë humori, atëherë mund ta kesh kaluar kufirin.* (Mapo, 27 korrik 2011)

Shënim I: 1. Vlerë përgjithësuese bartin dhe konstruktet e mëposhtme të barazvlefshme me *mund/duhet + lidhore*: *Sa për ato që thoshte Petriti rreth parësisë që merrte në rrethanat e kohës lufta për çlirimin e Atdheut, Peri ishte në një mendje, se, domosdo, pa i rregulluar njëherë punët me të huajin, nuk ke si t'i rregullosh me kapitalistët "e tu".* (Lulja, vëll. 1, f. 304). **nuk ke si t'i rregullosh = nuk mund t'i rregullosh** (vlerë modale e mundësisë) *Dhe kur e thotë "patrioti" Pollo, nuk të mbetet veç ta besosh.* (Shekulli, 18 korrik, 2011) **nuk të mbetet veç ta besosh = duhet ta besosh** (vlerë modale e domosdoshmërisë)

2. I shtojmë shembujve të mësipërm dhe konstruktet tautologjike që vijojnë, konstruktet që shoqërohen dhe nga pjesëza **dot**⁹. Krahas nuancimeve kuptimore të theksimit e nënvizimit që janë të njohura tashmë, duam të shtojmë këtu jo vetëm kuptimin përgjithësues, por edhe kuptimin e vlerën e mundësisë (për folje në pohore) dhe të pamundësisë (për folje në mohore). *Zjarri nuk mbahet me libra, ndonëse mund ta ndezësh me libra, por me librat e tyre as për ta ndezur nuk e ndizje dot zjarrin, se ishin akull të ftohtë.* (Lulja, 2, f. 23) **për ta ndezur nuk e ndizje dot = nuk mund ta ndizje**; *Shqiptarin, arrë të fortë, për të thyer s'e thyen dot, po në gliko mund edhe ta përtpësh, si kaçkë!* (Shuteriqi, f. 227) **për të thyer s'e thyen dot = nuk mund ta thyesh.**

c) habitore: e tashme: *"Me flori bleke edhe sëmundjen e fëlliqur të bukurisë..."*, - *po thoshte sot me vete i biri...* (Lulja, vëll. 2, f. 528).

d) dëshirore: e tashme: *Edhe në mos zënc sot, zë nesër, se në peshkim shpresa është e përditshme, jo si në bujqësi, ku është e përvitshme.* (Lulja, vëll. 1, f. 300).

e) urdhërore: *"Gratë nuk përgojosen në tryezën e burrave... - tha arhondi i vogël. - Burrin përgojose, në je burrë..."* (Lulja, vëll. 2, f. 177).; *Ku s'ka provuar të ngrejë urë një romak, mos provo, se të shkon huq;* (Shuteriqi, f. 169)

1.2 Foljen me kuptim gramatikor përgjithësues përveç se në vetën e dytë numër njëjës të mënyrave të ndryshme e kemi hasur dhe në **vetën e parë shumës**, më së shumti në të tashmen e mënyrës dëftore, lidhore e dëshirore, por mund të flasim për një përdorim më të vogël të saj, raste të njohura tashmë dhe nga Gramatika e Akademisë:

⁹ Sipas S. Floqit, në artikullin *Konstrukte tautologjike në shqipen e sotme*, në SF, 1968/3, f. 48, "Konstruktet tautologjike shprehin kuptime e nuanca të ndryshme si theksim të një cilësie a të një procesi.."

Porse jeta, sa na bën kureshtarë për shumë gjëra, aq edhe na pengon që t'i njohim. (Dh. Shuteriqi, f. 227) *Atje ku nuk ia mban dot trimërisë, i falemi dhëlpërisë..., - i tha arhondi i madh në vesh priftit të Shënedielës.* (Lulja, vëll. 2, f. 115). *Ky është një njeri i vdekurë; sado ta duamë të vdekurinë, duhetë ta vëmë në dhet* (Shqipëria..., f. 61); *Nuk themi lavdi Zotit që nuk na shqeu leckash, siç bëri me Greqinë, po dashkemi të bëjmë dhe naze.* (Darka, f. 13); si dhe konstrukti: *Një herë kemi për të vdekë!* (Përralla, f. 225) *kemi për të vdekë = do të vdesim* (e ardhmja e sigurisë)

1.3 Krahas vetave të lartpërmendura, është i njohur kuptimi përgjithësues i foljes dhe në **vetën e dytë numër shumës**, kryesisht në mënyrën urdhërore, lidhore, dëftore, nuk mungon dhe dëshirorja: *Kaqë kombe, që janë shuarë, mos pandehni se vdiqn' a u vranë të tërë;* (Shqipëria..., f. 29); *Të gjitha veprat artistike "të ekspozuara" janë të padukshme, së bashku me to mund të merrni edhe përshkrimin me të cilin ju mund ta kuptoni botën paralele të pikturës e cila nuk duket fare, por ekziston.* (Mapo, 23 korrik 2011); - *Sikur të shkruheshin afishe të mëdha dhe të vendoseshin nëpër qoshet e rrugëve: "Mos e merrziti njeri-tjetrin. Mos e lini vetëm."* (Përbindëshi, f. 131); *Dy mësim të mëdha: me pashallarët s'fitohet përfundimisht liria; fqinjët i paçim miq, po besimin te vetja.* (Shuteriqi, f. 236); si dhe konstrukti: *Nuk mjafton të blini vetëm kostum të ri, kapelë ose syze interesante, keni nevojë të punoni pak dhe me tenin e lëkurës suaj.* (Mapo, 23 korrik 2011) *keni nevojë të punoni = duhet të punoni...* (vlerë modale e domosdoshmërisë)

1.4 Nga sa pamë më lart, nuk përmenden raste të kuptimit përgjithësues në **vetën e parë njëjës**, të cilësdo mënyre qoftë ajo. Por a mund të flasim për ambiguitet edhe në këtë vetë? Mendojmë se kemi kuptim përgjithësues edhe në vetën e parë njëjës në rastet e përdorimit të saj në sentencat popullore, brendia e të cilave shpreh konkluzione të një përvoje të gjatë shekullore dhe vlera përmbajtësore e tyre është jo vetëm gjithëkohore, por edhe gjithënjëzore: *Sa të fus merak, ma mirë i ve kapak.* (Sh. Haxhihyseni, "Gur i randë n'vend të vet", f. 130) *Ku futsha kamët, m'rafshin dhamët.* (po aty)

1.5 Mendojmë se ambiguitetin vetë e shenjuar – vetë e përgjithësuar nuk e gjejmë në rastet e vetës së tretë njëjës a shumës.¹⁰ Kuptimi përgjithësues që vihet re në këto përdorime lidhet me vepruesin e pashprehur¹¹ dhe jo me vetën e tretë të foljes: *Dhe fataliteti i guximeve njihet, e dashura bija ime.*

¹⁰ Në Gramatikën e Akademisë veta e tretë njëjës e shumës shihet edhe si me kuptim përgjithësues.

¹¹ Përsa i përket çështjes së vepruesit të shprehur apo të pashprehur, duhet thënë se rastet e shprehjes së tij në ndërtimin pësor të fjalisë janë të rralla në gjuhën shqipe, kjo sepse ose vepruesi është i njohur dhe nuk është e nevojshme të shprehet, ose sepse është i panjohur dhe nuk mund të përcaktohet lehtë. Ka një arsye të caktuar kur vepruesi është i shprehur. Shih për më tepër M. Karapinjalli, "Kërkime dhe studime në fushën e gjuhës shqipe", Sejko 2001, f. 22-24.

(Shuteriqi, f. 230). Siç shihet, vetës së tretë i përgjigjet kryefjala *fataliteti i guximeve* dhe kuptimi përgjithësues nuk ka asnjë lidhje me të. Për ta qartësuar më tej idenë sjellim dhe një tjetër shembull, rast i shprehjes së vepruesit me përemrin e pacaktuar **të gjithë**: *...po, siç dihet nga të gjithë, ne ortodoksia dhe ata katoliqua nuk jemi marrë e nuk po merremi dot vesh, për të keqen tonë, se ky turku që përfshiu viset ortodokse që kish pranë, u është përveshur dhe viseve katolike.* (Shuteriqi, f. 51)

Nga sa pamë deri tani, mund të themi se e takojmë kuptimin përgjithësues në format e shtjelluara veprore dhe joveprore, në foljet vetore, por e gjejmë edhe tek ato pavetore: *Murit me kokë nuk i bihet, - i thashë.* (Agolli, f. 13); *Dhe pse i thuhet nganjëherë derrit dajë!* (Shuteriqi, f. 113); *Andej ishte vështirë të kalohej, por kapëdan Kadri Gurra i dinte mirë këto vende...* (Agolli, f. 108)

Krahas formave të shtjelluara të foljes, gjejmë kuptimin përgjithësues dhe në format e pashtjelluara dhe në këto të fundit falë tipareve foljore të tyre¹². Deri tani nuk kemi ndeshur në trajtimin e kësaj çështjeje, por nisur nga tiparet foljore të formave të pashtjelluara (pavarësisht faktit se ato nuk kanë fleksion dhe nuk mund të marrin një vetë) mund të themi se ato shprehin një veprim si proces e në gjykimin tonë vepruesi është përgjithësues ose jo në varësi të kontekstit: *Moli fillonte nga një cektinë.... dhe mbaronte te thellësitë e mëdha blu, që të kallnin datën e të merrnin mendtë kur ulje kryet për t'i vështruar.* (Lulja, 2, f. 509); *Me t'u futur në këtë vendbanim të madh, hetoje e përjetoje ankthin e rrezikut...* (Lulja, 1, f. 175) *Sa lezet qenka me fjetë kështu!* (Përralla, f. 74); *Larg shumë. Vështirë asht me shkue.* (Përralla, f. 250); *Asgjë e mirë nuk bëhet në këtë botë, pa i larë sytë njëherë nga bloza e natës...* (Lulja, 2, f. 275)

2. Kryefjala e kundrinori përgjithësues

Sapo flasim për kryefjalë përgjithësuese bie pretendimi që kuptimi përgjithësues ndeshet në fjalitë njëkryegjymtyrëshe me vetë të përgjithësuar (përcaktim sipas Gramatikës së Akademisë). Në raste të caktuara këtë pretendim e rrëzon dhe prania e kundrinorëve përgjithësues (këto të fundit vënë re për herë të parë nga Remzi Përnaska)¹³. Më së shumti **kryefjala**

¹² “Në rrafshin teorik format e pashtjelluara të foljes janë kategori gjuhësore ndërmjetëse sepse gërshetojnë karakteristika të pjesëve të ndryshme të ligjëratës: nga njëra anë, çdo formë e pashtjelluar ka karakteristikat e foljes, që janë karakteristika të pamungueshme, të cilat lidhin atë me sistemin foljor; nga ana tjetër, çdo formë e pashtjelluar ka dhe karakteristike të një pjese tjetër ligjërate e pikërisht ato të emrit, mbiemrit ose të ndajfoljes, të cilat e lidhin atë përkatësisht me sistemin emëror, mbiemëror, a ndajfoljor.” *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, M. Çeliku, f. 219.

¹³ “Në gramatikat e gjuhës shqipe, të botuara pas vitit 1970, flitet edhe për fjali njëkryegjymtyrëshe. Lloji më i rëndomtë i fjalive njëkryegjymtyrëshe është ai gjymtyra kryesore e të cilit është shprehur me folje vetore. Fjalitë me një gjymtyrë kryesore të shprehur me folje në trajtë vetore, vetën mund ta ketë të përcaktuar, të papërcaktuar, të

përgjithësues është e pashprehur në strukturën sipërfaqësore të fjalisë¹⁴. Në rastet kur është e shprehur ajo takohet si përemër vetor, përemër i pacaktuar, apo emër:

Ti përpiqesh të ngresh kulturën tënde, ai tjetri vjen e ta rrafshon (Dh. Shuteriqi, f. 230); *Ne shpesh shajmë një tjetër për të mbrojtur atë që e kemi më pranë lëkurës*. (Agolli, f. 206); *Ju mund të na shkruani në lidhje me sugjerimet, vërejtjet apo këshillat tuaja...* (Shekulli, 18 korrik, 2011); *Ne të gjithë nuk e dimë se ç'mendon...* (D. Agolli, f. 176); *Ishte shpresë të fitohej pa derdhur një pikë gjak, nga shkaku që tërë bota besonin që Skënderbeu do t'i binte Sfetigradit...* (Noli, f. 153); *Në këto çaste, si për t'u mbrojtur nga ulërima e vdekur e shkretëtirës, njeriu kërkon të kapet pas diçkaje: pas një libri, një mendimi, një fytyre të dashur*. (Autobiografia, f. 9).

Ndërsa **kundrinorët përgjithësues** shprehen kryesisht me trajtë të shkurtër të përemrit vetor¹⁵, por nuk mungojnë dhe raste të emrave apo përemrave: *Errësira të kallte datën*. (Mapo, 27 korrik 2011); *Unë e njoh mirë turkun. Ai përpiqet t'ia shtrembërojë shpirtin njeriut, ta bëjë armik të vetes së vet, të fisit të vet, shtypës të dheut të vet*. (Kuteli, f. 264); *Po edhe vetmia të ngushëlloka, se të bën të mendohesh*. (Lulja, 2, f. 270); *Duhet të provoni*

përgjithësuar. Veta të tilla, sigurisht ndonjëherë me largime jo të parëndësishme, njeh dhe kundranori. Nuk është vendi të ndalemi këtu te veçantitë e kategorisë gramatikore të vetës te kundranori, vetëm se do të japim një ndërtim të pavënere nga studiuesit. Kështu, p.sh. kur kushtet ligjërimore plotësohen, “trajta e shkurtër e përemrit vetor të vetës së dytë njëjës” shenjon një kundranor me vetë të përgjithësuar, si te shembujt e mëposhtëm: *Urtësia e popullit gjithnjë të befason*, Drita, 12 dhjetor, 1982, f. 1; *Atij që nuk të do, po t'i japësh majzën e thoit, të rrëmben gishtin, në i dhësh gishtin të merr dorën; po i dhe dorën, të merr trupin dhe po të kapi trupin, të mori shpirtin*. (N. Bulka, Legjenda e një fisi, Tiranë, 1966, f. 6), Remzi Përnaska, “Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe”, Studime Filologjike, 1983/4, f. 194. Do të saktësonim se në shembullin: *Urtësia e popullit gjithnjë të befason*, nuk bëhet fjalë më për fjali njëkryegjymtyrëshe, por për fjali dykryegjymtyrëshe. Kryefjala është e shprehur me togfjalëshin e lirë: *urtësia e popullit*. Siç shihet, vlera përgjithësuese është karakteristike sa e fjalive njëkryegjymtyrëshe, aq dhe e fjalive dykryegjymtyrëshe, por kjo çështje do të jetë objekt i një tjetër punimi.

¹⁴ “Përemrat vetorë të vetës së parë e të dytë të rasës emërore, në funksion të kryefjalës zakonisht nuk shprehen. Kjo lidhet me specifikën e shqipes, e cila nuk e ka të domosdoshme praninë e vetorit si kryefjalë, sepse folja me format e saj përgjithësisht e dallon qartë vetën. Ata përdoren vetëm me qëllime të caktuara, kryesisht stilistike, sidomos kur duam të spikasim kryefjalën, ose kur duam të vemë përballë njëra-tjetrës dy kryefjalë.” Gramatika e Akademisë (morfolgjia), f. 223. Të njëjtën mendim për kryefjalën e shprehur me përemër vetor të vetës së parë dhe të dytë gjejmë dhe te Gram. Praktike, f. 86.

¹⁵ E njëj kuptimin përgjithësues në trajtat e shkurtra dhe M. Çeliku në “Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)”, Tiranë 2012, f. 168-171, por nuk i sheh ato si kundrinorë, por thjesht si formante gramatikore, caktuesorë.

imazhin e ri, nëse keni dëshirë që i tërë plazhi ta kthejë kokën nga ju dhe të flasë për ju në tërë bregun. (Mapo, 23 korrik 2011).

3. Mbiemri përgjithësues

Ndonëse nuk kemi parë të flitet deri më sot dhe në korpusin tonë e kemi ndeshur në raste të pakta, ne mendojmë se kuptim përgjithësues bartin dhe mbiemrat. Zgjuan interesin tonë mbiemrat e prejardhur, prejfoljorët formuar me prapashtesën –**shëm**¹⁶ dhe po ju sjellim shembullin e mëposhtëm: *Më i gjerë si varg, pa dyshim, është tetërrokëshi. Ai është më i gjithëgjend-shmi e më demokratiku*¹⁷.

Le të ndalojmë te mbiemri që mendojmë se ka kuptim përgjithësues: *më i gjithëgjend-shmi = që gjendet kudo*. Përderisa vlera kuptimore e këtij mbiemri është e barazvlefshme me një sifjali përcaktore dhe tregon një veprim¹⁸, atëherë kemi një veprues që në varësi të situatës mund të jetë i përcaktuar, i papërcaktuar apo i përgjithësuar. Në rastin tonë mendojmë se është i përgjithësuar dhe sifjalia përcaktore do të zgjerohej: *që gjendet kudo nga të gjithë*. Për të hequr dyshimin se kuptimin përgjithësues e bart përemri i pacaktuar *gjithë* që është në trup të mbiemrit dhe jo mbiemri si i tillë po sjellim një tjetër rast: a) *Kishte nofka të kapshme lehtë, me njëfarë kuptimi, si “Shoku vetëtimë” ose “Grushti”,...* (Darka, f. 58) = *Kishte nofka që kapeshin lehtë* (nga të gjithë), *me njëfarë kuptimi, si “Shoku vetëtimë” ose “Grushti”,...*; b) *Kjo është plotësisht e kuptueshme*: (Autobiografia, f. 32) = *Kjo kuptohet plotësisht*. (nga të gjithë).

Këto përdorime të **mbiemrave përgjithësues** mund të na çojnë drejt disa përfundimeve: a) Mbiemrat përgjithësues kanë kuptim jovepror dhe kërkojnë një veprues përgjithësues; b) Bartin kuptim përgjithësues kryesisht mbiemrat e prejardhur prejfoljorë me prapashtesën –**shëm**, të tipit *i kapshëm, i ngrënëshëm*, por duhet të theksojmë se jo të gjithë. Të tillë janë vetëm ato mbiemra që e ruajnë lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes

¹⁶ Në Gramatikën e Akademisë (morfologjia), në kapitullin ku bëhet fjalë për mbiemrin, gjatë trajtimit të formimit prapashtesor të tij paraqiten dhe mbiemrat prejfoljorë formuar me këtë prapashtesë (-**shëm**). “Një pjesë e këtyre mbiemrave prejfoljorë kanë kuptim veprues, tregojnë edhe aftësinë e mundësinë e sendit të karakterizuar nga mbiemri i dhënë për të kryer veprimin e emërtuar nga tema fjalëformuese e atij mbiemri.... Pjesa tjetër e tyre, më e madhja, tregon aftësinë, mundësinë, meritimin, domosdoshmërinë për t’iu nënshtruar sendi i dhënë veprimit të emërtuar nga tema fjalëformuese e mbiemrit,.... Disa mbiemra prejfoljorë mund të kenë sipas rrethanave e kontekstit, kuptim vepror ose pësor, p.sh.: *i dëgjueshëm* (= që dëgjon ose që dëgjohej): *fëmijë i dëgjueshëm* dhe *tingull i dëgjueshëm*.” (f. 194)

¹⁷ Autobiografia, f. 157.

¹⁸ Kuptimin veprues të këtyre mbiemrave e njeh dhe Ali Dhrimo në artikullin *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 1972/3.

përkatëse¹⁹. c) Mbiemri përgjithësues mund të kryejë në fjali funksion përcaktori ose të jetë pjesë emërore e kallëzuesit emëror, dhe respektivisht duhet të jetë i barazvlefshëm me një sifjali përcaktore, ose me një folje të formës joveprore.

4. Raste të tjera

Mendojmë se mund të flasim për përdorime me kuptim përgjithësues dhe te **pronorët** e vetës së parë shumës dhe vetës së dytë numër njëjës e shumës, po ashtu dhe te **përemrat e pacaktuar**, por vetëm në rastin e një përdorimi joanforik të tyre. Mund të jenë një anaforë vetëm kur i referohen një vepruesi përgjithësues, p.sh.: **Hapni tani një llogari kursimi Alpha Smart dhe maksimizoni me zgjuarsi përfitimet tuaja!** (Shekulli, 18 korrik); **Por në lufrat e shumta me dhunonjës të shumtë trimi ynë kish marrë nëntë plagë në shtat dhe tani kish nëntë vjet që dergjej në kullë.** (Kuteli, f. 58); **Është e frikshme të mendosh se autori i ka përgatitur veprimet e tij përgjatë dy viteve pa qenë i trazuar nga kurrkush.**²⁰. (Mapo, 27 korrik 2011)

Përdorime me kuptim përgjithësues gjejmë dhe te plotësi etik²¹, quajtur ndryshe dhe **dhanorja etike**. Evidentohet ky fakt, veçanërisht, në rastet e vetës së parë numër shumës, më rrallë në vetën e dytë njëjës, para foljeve të mënyrës habitore, në të gjitha kohët e saj: **Kam thënë edhe unë gjer dje, që gjaku s' bëhet ujë, po ja që na qenka ndryshe:** (Shuteriqi, f. 204); **Dhe ti tani,**

¹⁹ Pavli Haxhillazi në “Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe”, SF, 1969/2 ndër të tjera bën një klasifikim të mbiemrave në bazë të lidhjes që ekziston ose jo, ndërmjet kuptimit të mbiemrit foljor në –shëm, dhe kuptimit të foljes që përbën temën prodhuese të mbiemrit. Kështu kemi: I) Grupi i mbiemrave, që e ruajnë lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes përkatëse. Në bazë të kësaj lidhjeje përcaktohet përmbajtja e tiparit që shënon mbiemri dhe II) Grupi i mbiemrave që nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me kuptimin leksikor të foljes që përbën temën prodhuese. Nga ana strukturore duket qartë se në temën e tyre prodhuese këta mbiemra kanë një formë të pjesores së foljes, kurse nga ana semantike, kjo është zbehur nga kuptimi foljor. Këta mbiemra shprehin tipare të një gjendjeje të caktuar dhe nuk shprehin aftësinë e mundësinë e kryerjes së një veprimi ose të nënshtrimit ndaj një veprimi. (f. 145 – 164)

²⁰ Në Gramatikën e Akademisë (morfologjia), në kapitullin ku flitet për përemrin e pacaktuar thuhet: “Veçoria themelore kuptimore e përemrave të pacaktuar është pacaktuesia. Ky kuptim shumë i përgjithshëm i përemrave të pacaktuar ruhet në çdo rrethanë ligjërimi. Këtu ata dallohen nga të gjithë përemrat e tjerë, kuptimi i të cilëve përcaktohet nga konteksti a situata e ligjërimin. Kuptimi i përemrave *dikush, askush, gjithë, secili* etj. në çdo kontekst mbetet i pandryshuar, ...” (f. 249). Ndryshe, ne jemi të mendimit se dhe kuptimi i këtyre përemrave varet nga konteksti dhe në raste të caktuara ato bartin vlerë përgjithësuese. Në rastin e shembullit tonë themi se kemi përdorim përgjithësues të përemrit të pacaktuar **kurrkush**. Po ky përemër, në një tjetër kontekst, mund të mos përdoret me të njëjtën vlerë si p.sh.: **Të fuarit po bisedonin. Autori nuk u pa nga kurrkush.** Përdorimi anaforik i përemrit të pacaktuar **kurrkush** tregon qartë se bëhet fjalë për të fuarit dhe jo për këdo nga ne.

²¹ E quan kështu Mahir Domi te “Gramatika e gjuhës shqipe, sintaksa”, 1954, f. 58.

ja, hopa **na marrke** një grek, ... (Agolli, f. 81); “**Na qenki trima në të parë, na paski gjerdanë palë-palë, po dardha e ka bishtin prapa, do t’ju shohim!**” (Agolli, f. 18); **Na ishte një herë një mbret. Ky na kishte një vajzë.** (Përralla, f. 114).

Në përfundim mund të themi se kuptimi përgjithësues është një dukuri që haset shpesh në gjuhën shqipe në struktura e kontekste të caktuara gjuhësore dhe vjen si i tillë në kuadrin e thënies. Ambiguiteti vetë e shënuar – vetë përgjithësuese lidhet më së shumti me vetorët e vetës së parë e të dytë numër njëjës e shumës, me të gjitha mënyrat dhe kohët më të përdorshme të foljes, me format veprorë e joveprorë të saj. Gjithashtu, mund të flasim për kuptim përgjithësues edhe te foljet pavetore e për më tepër dhe tek të gjitha trajtat e formave të pashtjelluara të foljes. Ndonëse, siç shihet, lidhet ngushtë me foljen, rastet përdorimore na flasin jo vetëm për vetorë përgjithësues, por edhe për pronorë përgjithësues e përemra të pacaktuar përgjithësues. Nuk mungojnë dhe raste të mbiemrave përgjithësues.

LISTA E LIBRAVE TË VJELA SHTERUESHËM DHE SHKURTIMET

- ❖ *Përralla shqiptare*, Tiranë, 304 f. (Përralla)
- ❖ Jakov Xoxa, *Lulja e kripës*, Vëll. 1, Tiranë, 1980, 488 f. (Lulja, vëll. 1)
- ❖ Jakov Xoxa, *Lulja e kripës*, Vëll. 2, Tiranë, 1981, 628 f. (Lulja, vëll. 2)
- ❖ Dritëro Agolli, *Zhurma e erërave të dikurshme*, Onufri 2006, 384 f. (Agolli)
- ❖ Ismail Kadare, *Përbindëshi*, Tiranë, 1991, 184 f. (Përbindëshi)
- ❖ Ismail Kadare, *Darka e gabuar*, Onufri 2009 (botimi i tretë), 206 f. (Darka)
- ❖ Ismail Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Onufri 2002 (botimi i tretë), 176 f. (Autobiografia)
- ❖ Fan Noli, Vepra 4, Tiranë 1989, *Historia e Skënderbeut* (“Dielli”, Boston, 1921, 172 f.) (Noli)
- ❖ Mitrush Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare*, Tiranë, 2005, 296 f. (Kuteli)
- ❖ Dhimitër Shuteriqi, Vepra letrare 4, Tiranë 1982, 368 f. (Shuteriqi)
- ❖ Veronika Haxhistasa, Jalldyz Xhemalaj, *Kimia 8*, Mediaprint 2008, 72 f. (Kimia)
- ❖ Sami Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet, Tiranë, 1962, 110 f. (Shqipëria)

GAZETA TË VJELA SHTERUESHËM

- ❖ “Panorama”, 17, 24, 28, 29 korrik 2011.
- ❖ “Panorama”, 8 nëntor 2011.
- ❖ “Mapo”, 19, 23, 27 korrik 2011.
- ❖ “Shekulli”, 18 korrik 2011.

BIBLIOGRAFI

- A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 1972/3.
Akademia e Shkencave, *Fjalori i termave të gjuhësisë*, Tiranë, 1975.
Akademia e Shkencave, *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë (1954, 1980, 1984, 2002, 2006).
Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 (Morfologjia)*, Tiranë, 1995.
Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2 (Sintaksa)*, Tiranë, 2002.
Akademia e Shkencave, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Tiranë, 1988
Elezi Dodbiba, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, 1959.

MERITA BALLIÇI

- F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, 251 f.
- J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë, 1999.
- J. Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë 1989.
- J. Thomaj, *Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në gjuhën shqipe*, SF, 1969/1.
- K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, 192 f.
- M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, ShBLU, ribotim, 2006.
- M. Çeliku, M. Karapinjalli, R. Stringa, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 1998, 496 f.
- M. Çeliku, *Sintaksa e gjuhës së sotme letrare shqipe*, Elbasan, (leksione), 1980.
- M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, M. Çeliku, Tiranë 2012.
- M. Çeliku, *Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde*, ILAR, Tiranë, 2008.
- M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa*, Tiranë 1954.
- M. Karapinjalli, *Kërkime dhe studime në fushën e gjuhës shqipe*, Sejko 2001.
- M. Pougéoise, *Dictionnaire de grammaire et des difficultés grammaticales*, Armand Colin, 1998.
- P. Haxhillazi, *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe*, SF, 1969/2.
- Patrick Charaudeau, *Grammaire du sens et de l'expression*, Paris, 1992.
- R. Përnaska, *Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe*, SF, 1983/4.
- R. Përnaska, *Gjuhësia e të thënit*, leksione (të pabotuara), 42 faqe.
- S. Floqi, *Konstrukte tautologjike në shqipen e sotme*, SF, 1968/3.
- Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë 1972, 296 f.
- Sh. Demiraj, *Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe*, SF, 1969/4.
- Sh. Demiraj, *Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe*, botuar në SF, 1971/1.
- Sh. Haxhihyseni, *Gur i randë n'vënd të vet*, Sejko, 2004, 333 f.
- Universiteti i Tiranës, *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, 427 f.